

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

|         |                                                                                                                                                                                                                                                                   |
|---------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| TITULLI | Organizatorët apelojnë te partitë të mos i politizojnë protestat kundër vendimit të Speciales                                                                                                                                                                     |
| ADRESA  | <a href="https://www.koha.net/arberi/organizatoret-apelojne-te-partite-te-mos-i-politizojne-protestat-kunder-vendimit-te-speciales">https://www.koha.net/arberi/organizatoret-apelojne-te-partite-te-mos-i-politizojne-protestat-kunder-vendimit-te-speciales</a> |
| BURIMI  | koha.net                                                                                                                                                                                                                                                          |
| GJENDJA | online                                                                                                                                                                                                                                                            |

## KOHA


|                       |                                                                                                                                                           |
|-----------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KAPUR NGA NE          | 20 shtator 2026, 04:05:42 UTC<br><i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>                            |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 19 shtator 2026, 17:03:19 UTC<br><i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i> |

## HASH-ET · SHA-256

|            |                                                                  |
|------------|------------------------------------------------------------------|
| PËRMBAJTJA | 137f398914cf14e002f2931850f22162b41aa63873f9a6451ffed18779dc086e |
| TEKSTI     | 5e60d3ca4fdc3ecbcf2db4c7e27b70f4fbe57074855f51555fa3885927090fc5 |
| PAMJA      | 9bd38af3d041fca6fe0a0f1f95c1a891c30bb9d5d5e9943d9093292625faccce |

## ZINXHIRI I PROVËS

|               |                                                                                                 |
|---------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KJO HYRJE     | fb514ce794cae3471f30fd734a4be4bf4ca3fe50cd97dc059702f6b8a8af24f4                                |
| E MËPARSHMJA  | —                                                                                               |
| RRËNJA MERKLE | 77f62ff964619b499e7abd6ec0b68bd7082a3350b84662b73410ae03800ae3c8                                |
| ANKORIMI      | submitted — dërguar, ende pa bllok<br><i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i> |



## SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/fb514ce794cae3471f30fd734a4be4bf4ca3fe50cd97dc059702f6b8a8af24f4>

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



ARBËRI

## Organizatorët apelojnë te partitë të mos i politizojnë protestat kundër vendimit të Speciales



Foto: Driton Paçarada

19 shtator 2026 19:03

Shpërndaje në:



Klikoni këtu nëse dëshironi t'i lexoni lajmet e fundit dhe të përzgjedhura në kanalën tonë zyrtar në Viber

Nga ora 21:00, për të katërtën natë radhazi, qytetarët janë thirrur të mbledhen në sheshet e Prishtinës për të kundërshtuar verdiktin dënues ndaj udhëheqësve të UÇK-së. Organizatorët thonë se protestat do të vazhdojnë edhe në ditët në vijim, dhe u bënë apel partive politike të heqin dorë nga mësymja për politizim.

Për të katërtën natë radhazi, në sheshet e Prishtinës, protestohet nga ora 21:00, kundër vendimit dënues të Gjykatës ndaj katër udhëheqësve të UÇK-së.

Një prej organizatorëve të protestave, Çlirim Haziri, tha se ato nuk do të ndalen, deri në realizimin e kërkesave. Haziri bëri thirrje që protesta të mos politizohet.

"Duhet ta dinë të gjitha partitë politike që, ne po jemi dëshmitarë të një tendence të madhe të të gjitha partive, si opozitare, si partive në pushtet, me e politizu. Dikush duke thënë se janë të partive opozitare e dikush të partisë në pushtet, po duhet me ditë që ky është zani i rinisë, një brez që UÇK-ja ka luftu për të e ky brez sot nuk bën me lënë vet. Ideja është me pasë një protestë dinjitoze e jo protestues që shkaktojnë probleme", u shpreh ai.

Protestë në shesh u mbajt edhe të premten mbrëmë nga ora 21:00. Në orët më të vona, një numër protestuesish vazhduan rugën drejt zyrave të EULEX-it.

E, sipas Policisë, pas protestës para ndërtesës së EULEX-it, është shkaktuar rrezik për pjesëmarrësit në trafik.

Edhe



Arbëri • 7 o. më parë

Organizatorët: Nuk na ka bashkuar partia – na ka bashkuar UÇK-ja

**Showbiz.**

"Animals" e rikthen yllin Ben Affleck si regjisor

**Futboll.**

Rrahmani zëvendësues, Lazio mposht Veneziën

**Futboll.**

Raphinha i pandalshëm, Barça fiton 3:1 ndaj Sevilias

Detonimet e tyre me vetura përveç krijimit të koionave në trafik, kanë kryer edhe vozitje të rrezikshme, madje edhe kanë shkaktuar rrezik për pjesëmarrësit e tjerë në trafik, por edhe për veten e tyre. Policia e Kosovës është detyruar që të ndërmarrë masa shtesë në trafik, të ndërpresë dhe riorientojë përkohësisht trafikun", thuhet në njoftimin e Policisë.

Krahas protestës në mbrëmje, gjatë ditës së premte mijëra qytetarë protestuan në shesh, të ftuar nga organizatat e dala nga lufta.

Nënkryetari i organizatës së veteranëve të luftës së UÇK-së, Gazmend Syla, ka thënë se të tilla protesta do të organizohen përsëri.

"Ka mundësi që të mërkurën vendosim me pasë protestë. Por kemi menduar me decentralizua protestën. Ka mundësi me realizua në komuna ku i kemi degët tona që funksionojnë atje", tha Syla.

Për të kundërshtuar verdiktin gjykues të Gjykatës Speciale në Hagë për ish-krerët e UÇK-së, protesta u organizuan edhe jashtë Kosovës.

Edhe



**Arbëri** • 17 o. më parë  
Policia: Protestuesit mbrëmë rrezikuan pjesëmarrësit në trafik dhe veten

Të shtunën, qindra mërgimtarë shqiptarë janë mbledhur në Helvetiaplatz të Cyrihut, në një tubim paqësor në shenjë kundërshtimi ndaj vendimit të Speciales. Protesta u organizuan edhe në Koln dhe Mynih të Gjermanisë, Kanada, e Vjenë të Austrisë.

Egzona Mema

#PROTESTA

#GJYKATA SPECIALE

Artikuj të ngjashëm



**Arbëri** • 12 o. më parë  
Në Cyrih protestohet kundër vendimit ndaj ish-krerëve të UÇK-së



**Arbëri** • 18 sht 2026  
"Jo në emrin tim", mijëra qytetarë në natën e tretë rresht kundërshtojnë vendimin e Speciales



**LAJMET E MBRËMJES** • 18 sht 2026  
Për të tretën ditë rresht, mijëra qytetarë protestojnë në Prishtinë kundër vendimit të Speciales

KOHA

Kjo faqe kontrollohet dhe menaxhohet nga KOHA. Të gjitha materialet në të, përfshirë fotografitë, janë të mbrojtura me copyright të KOHA-s dhe për to KOHA mban të drejtat e rezervuara. Materialet në këtë faqe nuk mund të përdoren për qëllime komerciale. Ndalohej kopjimi, riprodhimi, publikimi i paautorizuar qoftë origjinal apo i modifikuar në çfarëdo mënyre, pa lejen paraprake të KOHA-s. Shfrytëzimi i materialeve nga ndonjë faqe Interneti a medium tjetër pa lejen e Grupit KOHA, në emër të krejt njëjste që e përbëjnë (Koha Ditore, KohaVision, Koha.net, Botimet KOHA, KOHA Print dhe ARTA), është shkelje e drejtave të autorit dhe të pronës intelektuale sipas dispozitave ligjore në fuqi. Të gjithë shkelësit e këtyre të drejtave do të ballafaqohen me ligjin.

Marketing

Politika e privatësisë

Kushtet e përdorimit

Udhëzimet për përdorimin e IA-së

Cilësimet e privatësisë dhe

Shkarkoje aplikacionin e KOHËS



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.